



USHTRIA



Viti i 78-të i botimit Nr. 11 (827918)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 21 mars 2025

SHQIPËRIA, KROACIA DHE KOSOVA NËNSHKRUAJNË DEKLARATËN E PËRBASHKËT TË BASHKËPUNIMIT NË FUSHËN E MBROJTJES



» faqe 3



BAZA AJRORE E KUÇOVËS, ASET STRATEGJIK I NATO-s, ME DRONË DHE TEKNOLOGJI USHTARAKE TË FJALËS SË FUNDIT

Kryeministri Edi Rama dhe ministri i Mbrojtjes Pirro Vengu, të shoqëruar nga Komandanti i Forcës Ajrore, gjeneralmajor Ferdinand Dimo, inspektuan Bazën Ajrore të Kuçovës, e cila po kthehet në një aset strategjik të NATO-s, falë investimeve në infrastrukturë, modernizim dhe trajnime...



» faqe 2



EOD, HISTORI KRENARIE, GUXIMI DHE TRIMËRIE

Më 19 mars 1999, në Forcat e Armatosura mori jetë një grup i ri ekspertësh dhe profesionistësh xhenier, i kompletuar me ekspertizën e duhur në lëmin e asgjësimit të municioneve të paplasura. Në këtë nënrepart u thirrën më të mirët e të mirëve, pasi ky profesion kërkon guxim, dhe qartësi, për të marrë vendimin e duhur, ku jetën nga vdekja e ndan vetëm një vijë e hollë e padukshme. Për 26 vjet kjo strukturë na ka bërë krenar si brenda dhe jashtë...



» faqe 5



USHTARAKU QË SFIDËN E KA KTHYER NË MOTON E JETËS

Me kalimin e viteve, çdo sfidë është kthyer në një histori force dhe krenarie, ndaj në 80-vjetorin e krijimit të një prej institucioneve elitë të arsimit në Shqipëri, Shkollës 'Skënderbej', ku ti nise rrugëtimin tënd me uniformën e gjelbër në moshën 14-vjeçare, një djalë i ri me ëndrra të mëdha, me pasion dhe përkushtim për këtë thirrje që u bë pjesë e shpirtit tënd. Sot, pas 40 vitesh shërbimi, ti je ende po ai njeri, i fortë, i vendosur...



» faqe 6

Baza Ajrore e Kuçovës, aset strategjik i NATO-s, me dronë dhe teknologji ushtarake të fjalës së fundit

Kryeministri Edi Rama dhe ministri i Mbrojtjes Pirro Vengu, të shoqëruar nga Komandanti i Forcës Ajrore, gjeneralmajor Ferdinand Dimo, inspektuan Bazën Ajrore të Kuçovës, e cila po kthehet në një aset strategjik të NATO-s, falë investimeve në infrastrukturë, modernizim dhe trajnime.

Modernizimi i Forcës Ajrore, përfshirë edhe flotën e dronëve luftarakë, të cilët tashmë shërbejnë edhe për misione civile, mbetet një prioritet kyç për sigurinë kombëtare.

Drejtuesit e bazës e njohën kryeministrin Rama me investimet, armatimet dhe përforcimet ushtarake, ndërsa ministri Mbrojtjes Pirro Vengu e njohu kreun e qeverisë edhe me rritjen e shkallës së teknologjisë ushtarake dhe blerjeve të kryera që i shërbejnë Forcave të Armatosura.

Kryeministri Rama inspektoi dhe dhomat strategjike dhe operacionale të bazës, ku u informua për taktikat dhe cilësinë e pajisjeve bashkëkohore, si kamerat termale, dronët dhe distanca e filmimit të tyre deri në 40 km. Të gjitha këto në shërbim edhe të aksioneve të tjera si ndjekja e makinave, patrullimet detare dhe gjurmimet.

Drejtuesit e bazës përshkruan edhe patrullimet me avionë dhe dronë, jo vetëm të kufirit detar dhe tokësor, por edhe bashkëpunimi me agjenci të tjera ligjzbatuese ose jo.

Kryeministri u drejtoi disa pyetje teknike ushtarakëve, duke nënvizuar nëse kjo teknologji shërbente edhe për evidentimin e ndërtimeve pa leje. Ministri Vengu e njohu kreun e qeverisë edhe me investimet në infrastrukturë. Mjaft rëndësi i është dhënë dhe ndërtesave për akomodimin e 350 punonjësve të personelit të bazës.

Rehabilitim i ish-shtëpisë së oficerëve, që të do të jetë në kushte komode për personelin dhe familjarët, duke përfshirë salla, klasa dhe laboratorë.

Në fund u inspektua edhe hapësira për aktivitete jashtë profilin ushtarak, si ato sportive, palestra, sheshet e pushimit dhe të tjera ambiente çlodhëse të projektuara.



Kolegji i Mbrojtjes i NATO-s viziton Kolegjin e Mbrojtjes dhe Sigurisë

Kolegji i Mbrojtjes i NATO-s (NATO Defense College, NDC), me seli në Romë, Itali, në kuadër të programit studimor “Field Study Trip”, që zhvillon me kursantët e Kursit të 33-të të Bashkëpunimit Rajonal, zhvilloi vizitë në Kolegjin e Mbrojtjes dhe Sigurisë dhe në qytetin e Krujës. Delegacioni i Kolegjit të Mbrojtjes së NATO-s, përbëhej nga Dr. Suzanne Nielsen, dekane dhe zëvendës komandante e Kolegjit të Mbrojtjes së NATO-s, stafi mbështetës dhe anëtarë të kursit. Gjatë ditës së parë të vizitës, pjesëmarrësit e Kursit të 33-të, të Bashkëpunimit Rajonal, u pritën nga Komandanti i Kolegjit të Mbrojtjes dhe Sigurisë, gjeneral brigade Ylli Pulaj dhe stafi drejtues. Pjesëmarrësit e kursit të 33-të, të Bashkëpunimit Rajonal të Kolegjit të Mbrojtjes së NATO-s, ndoqën me mjaft interes prezantimet nga kolonel (R) Ardian Lulaj, mbi misionin dhe strukturën e Kolegjit të Mbrojtjes dhe Sigurisë; drejtori i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjeneral brigade Ardian Lilo, mbi “Kontributet e Shqipërisë në NATO, me fokus pikëpamjet tona për marrëdhëniet me Rusinë, mbështetjen për Ukrainën, baza ajrore e NATO-s në Kuçovë”; z. Gjergji Methoxha, drejtor i Përgjithshëm i Politikave të Mbrojtjes mbi “Politikat e mbrojtjes dhe interesat kombëtare në fushën e sigurisë, me fokus objektivat kombëtare në fushën e mbrojtjes, roli i Forcave të Armatosura, proceset e modernizimit dhe integrimi”; z. Besjan Kadiu, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjetikës mbi “Ekonominë mjedisore



dhe politikat energjetike, si udhërrëfyes për politikën tonë të jashtme me fokus në Gazsjellësin TAP, investimet në



energjinë e rinovueshme dhe masat kundër ndryshimeve klimatike”, dhe më pas nga znj. Megi Fino zëvendësministre e Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, e cila prezantoi mbi “Politikat zyrtare të Republikës së Shqipërisë, evolucioni dhe perspektiva e saj në të ardhmen, Integrimi Evropian, procesi i Berlinit, angazhimet e Republikës së Shqipërisë si anëtare jo e përhershme e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara”. Gjatë vizitës në Kolegjin e Mbrojtjes dhe Sigurisë Drejtuesja e delegacionit Dr. Suzanne Nielsen, në takim zyrtar me Komandantin e Kolegjit të Mbrojtjes dhe Sigurisë, gjeneral brigade Ylli Pulaj, diskutuan mbi rritjen e bashkëpunimit mes dy kolegeve në të ardhmen, si ura komunikimi të duhura për të ndërvepruar me qëllim rritjen e cilësisë së mësimdhënies, duke u përshtatur dhe me metodat inovative të kohës.

Vizita e pjesëmarrësve dhe stafit drejtues të Kolegjit të Mbrojtjes së NATO-s, përmban një aktivitet të veçantë për Kolegjin e Mbrojtjes dhe Sigurisë, pasi aktivitetet të tilla shërbejnë për forcimin e marrëdhënieve mes kolegeve homologe të vendeve të NATO-s, në fushën e trajnimit por edhe për njohjen e historisë dhe kulturës së vendit tonë.

SHQIPËRIA, KROACIA DHE KOSOVA NËNSHKRUAJNË DEKLARATËN E PËRBASHKËT TË BASHKËPUNIMIT NË FUSHËN E MBROJTJES

Ministri i Mbrojtjes Pirro Vengu, ai i Kroacisë Ivan Anushi dhe homologu i Kosovës Ejup Maqedonci nënshkruan në Tiranë një marrëveshje trepalëshe, ushtarake që synon të forcojë aftësitë mbrojtëse të tre vendeve, të rrisë bashkëpunimin në industrinë e mbrojtjes dhe të përmirësojë ndërveprimin ushtarak përmes edukimit, trajnimeve dhe stërvitjeve të përbashkëta.

Në konferencën e tyre për shtyp Ministri i Mbrojtjes Piro Vengu tha se: “Kemi një vlerësim të përbashkët të kërcënimeve në një mjedis sigurie të brishtë. Në këtë kontekst, angazhimi ynë për zhvillimin e kapaciteteve tona mbrojtëse, është më i fortë se kurrë.

Gjithashtu, Shqipëria dhe Kroacia do të punojnë ngushtësisht për unifikimin e qëndrimeve politike në mbështetje të aspiratave të qytetarëve të Kosovës për integrim të plotë në strukturat rajonale dhe euroatlantike”, – mbylli fjalën e tij ministri Vengu.

Ndërsa Ministri i Mbrojtjes i Kosovës, Ejup Maqedonci tha se kjo marrëveshje është finalizim i përpjekjes njëvjeçare që çoi në prodhimin e një deklaratë trepalëshe që i hap rrugë bashkëpunimit mes Shqipërisë, Kosovës dhe Kroacisë.

“Synimi i këtij bashkëpunimi nuk është një kërcënim ndaj askujt, por është një

mesazh për të gjithë ata që kërcënojnë sigurinë, paqen dhe stabilitetin në Ballkanin Perëndimor, mes vendeve tona që ndajnë vlera dhe interesa të përbashkëta. Ne jemi bashkuar për t’u përballur me çdo kërcënim dhe rrezik që synon destabilizimin e rajonit”, - tha ai.

“Rëndësia e këtij bashkëpunimi shtrihet edhe në rrafshet e tjera, veçanërisht në aspektin e industrisë së mbrojtjes, trajnimit, edukimit të personelit ushtarak, ndërsa adreson edhe çështjen e mbështetjes së dy vendeve për integrimin e Kosovës në strukturat euroatlantike”, - theksoi ministri Maqedonci.

Ministri i Mbrojtjes i Kosovës, u shpreh se: “Ky dokument hap rrugë edhe për bashkëpunime të ndryshme, në fusha të ndryshme, për t’u përballur me kërcënimet moderne siç janë ato hibride”.

“E vlerësoj këtë marrëveshje si një angazhim të përbashkët, që ndodh jo shpesh në rajon. Kemi një deklaratë ndër të parat që është bërë në fushën trelaterale dhe që hap rrugë për vende të tjera që t’i bashkëngjiten kësaj nisme për paqe, stabilitet dhe më shumë siguri”, - tha ministri Maqedonci.



Efektivë të Kompanisë EOD të Batalionit të Xhenios zhvilluan kursin “EOD Mentoring”

Në kuadër të zhvillimit të kapaciteteve operacionale, në kompaninë EOD të Batalionit të Xhenios u zhvillua kursi i specializuar “EOD Mentoring”, nën mbikëqyrjen e përfaqësuesve amerikanë nga organizata “Golden West”, duke kombinuar teori dhe praktikë në terren, si dhe stërvitje me municione reale në poligon.

Gjatë këtij programi intensiv, operatorët EOD ushtrojnë teknikat e avancuara për trajtimin e municioneve të paplasura, procedurat e sigurisë dhe metodat e asgjësimit përfundimtar të municioneve. Në poligonin EOD Rep.1060, pjesëmarrësit kryejnë veprime praktike për realizimin e teknikave Low Order, duke demonstruar aftësitë e tyre në kushte reale operacionale.

Ky kurs është një hap i rëndësishëm për rritjen e profesionalizmit dhe sigurisë në operacionet EOD, duke forcuar më tej bashkëpunimin me partnerët ndërkombëtarë në fushën e asgjësimit të mjeteve shpërthyes.



AFA pret studentë nga “West Point”

Akademia e Forcave të Armatosura mirëpriti studentët nga Akademia Ushtarake e Shteteve të Bashkuara, “West Point”, në kuadër të një shkëmbimi përvojë me studentët tanë. Ky bashkëpunim forcon lidhjet ndërmjet dy institucioneve dhe krijon mundësi të vjera për ndarjen e njohurive, aftësive dhe përvojave ushtarake. Studentët patën mundësinë të diskutojnë mbi sfidat e përgatitjes ushtarake, teknikat strategjike dhe rëndësinë e lidershit në Forcat e Armatosura. Ky është një hap i rëndësishëm drejt rritjes së bashkëpunimit ndërkombëtar dhe forcimit të aftësive të oficerëve të ardhshëm.



Certifikata mirënjohjeje për fituesit e Pesëgarëshit Ushtarak

Studentët e Akademisë së Forcave të Armatosura u shpallën fitues të garës Pesëgarësh Ushtarak. Përkushtimi dhe disiplina e tyre treguan edhe një herë nivelin e lartë të përgatitjes dhe vendosmërisë për të arritur sukses.

Në shenjë vlerësimi për këtë arritje të shkëlqyer, studentët u nderuan me certifikata mirënjohjeje nga gjeneral brigade Bardhyl Nuredinaj, si një simbol i punës dhe përkushtimit të tyre. Ky sukses nuk është vetëm një fitore sportive, por edhe një dëshmi e vlerave dhe aftësive që ata kultivojnë në këtë institucion.



Nënkolonel Behar Mara, ish-koleg,
protagonist i ngjarjeve të '97-s

28-vjetori i rënies në krye të detyrës së Dëshmorit të Atdheut, kapiten I Nuredin Gorçe. Kjo është motoja që ka udhëhequr ‘Komandot’ shqiptare në të gjitha misionet dhe detyrat që kanë kryer anembanë vendit. Kanë kaluar plot 28 vite që nga dita e rënies në krye të detyrës së heroit të parë të “Komandovë”, Kapiten I Nuredin Gorçe,

“Komando” janë një emër i dashur nga i gjithë populli jonë, kjo njohje vjen për faktin dhe peshën e madhe të detyrave që ata kanë kryer jo vetëm në misione jashtë vendit, por edhe rolin e veçantë që ata kanë luajtur në ngjarjet mjaft të vështira të trazirave të vitit 1999. Për çdo ushtarak, por edhe për çdo Shqiptar ngjarjet e vështira të '97-ës kujtohen me mjaft dhimbje për faktin se destabiliteti politik i vendit dhe anarshia e krijuar kudo i vuri strukturat e FA-së në vështirësi të mëdha për të përmbushur detyrat e tyre. Kjo erdhi për faktin se vala e revoltës mbarë popullore, si rezultat i humbjes së të ardhurave në firmat piramidale, solli një tërmet dhe revoltë popullore, e cila e shoqëruar edhe me paaftësinë e strukturave politike, institucionale, por edhe ushtarake për të drejtuar dhe menaxhuar situatën e krijuar, çoi në degradimin dhe përshkallëzimin e situatës deri hapjen e depove të armatimit, marrjen dhe shkatërrimin e arsenalit ushtarak të kohës. Pa dashur të bëj analogji dhe analizë të këtyre ngjarjeve, ajo që duhet të them si bashkëvuajtës i këtyre situatave është se zemërata e brendshme popullore ishte e aq e madhe dhe e drejtë, sa që asnjë ushtarak nuk mund të reagonte ndaj turmës së dëshpëruar, të cilët kërkonin kursimet e tyre tashmë të humbura.

Brigada ‘Komando’ e Zall-Herrit, e cila ishte krijuar në vitin 1995, si pasuese e strukturave të zbulimit, tashmë me 6 batalionet e saj të dislokuara në qytete të ndryshme të vendit, si Shkodër, Përmet, Pogradec, Berat dhe 2 batalione në Zall-Herr, Tiranë, ishin të angazhuara për të vendosur dhe ruajtur situatën e sigurisë tashmë të dalë jashtë kontrollit. Të ndodhur përballë kësaj situatë në gjykimin tim ishte e pamundur për të kryer detyra, pasi revolta ishte aq e madhe, ku do ishte më e udhës të shmangej vëlla-vrasja dhe të merreshin masa për të ruajtur repartet dhe kontribuar më tej në vendosjen e rendit tashmë të dalë jashtë kontrollit. Situata tashmë kishte precipituar, armët kishin rënë në dorën e popullit, Reparti i Zall-Herrit tashmë po haste vështirësi, sepse kishte dyndje të popullatës që kërkonin armë, por ata u përballën me vendosmërinë e oficerëve të patrembur, të cilët kishin vendosur të mbronin repartin, kështjellën e tyre të palëkundur të ruanin emrin e tyre të mirë, i cili ishte gdhendur në mendjen e çdo Shqiptari. Mbrojtja e repartit është detyrë për çdo ushtarak, por për ne ishte fatale të shkatërrohej kjo pasuri e ngritur me mund e djersë, rënia e kësaj strukture elitë do thoshte, se ushtria s’do kishte ringritje, emri “Komando” nuk do të ekzistonte, sepse vlerat që mbanin në këmbë këtë kolonë të fuqishme të FA-së do rrëzoheshin bashkë me atë fatalitet që sollën ngjarjet e zymta të '97-s.

A e përmbysën “Komandot” misionin e tyre përballë këtyre ngjarjeve të vështira?

Brigada “Komando” është ndër njësitë e vetme të FA-së, e cila nuk u dëmtua gjatë trazirave të '97-s, kjo falë vendosmërisë, përkushtimit dhe profesionalizmit të oficerëve, n/officerëve dhe ushtarëve të kësaj njësie elitë, të cilët jo vetëm e mbrojtën garnizonin e tyre, por u bënë burim frymëzimi edhe për repartet e tjera ku mund të shikonin sinjalet e shpresës për t’u ringritur dhe kryer misionin e tyre. Duke kujtuar me dhimbje këto ngjarje, por edhe duke qenë krenar për atë çfarë ne bëmë, jo vetëm për të ruajtur repartin, por edhe rolin që patën komandot më vonë në ruajtjen dhe sigurinë e objekteve të rëndësishme të vendit.

Është vështirë të sjellësh në vëmendje ngjare të tilla, si ato të Marsit të vitit '97 ku ne qëndruam me ditë dhe net të tëra, edhe pse reparti i rrethuar nga turma njerëzish nga katër anët, të cilët të irrituar kërkonin medoemos hapjen e repartit nga ku të merrnin armët, duke na njollosur dhe turpëruar dhe vënë përpara historisë, e cila këtë gabim s’do na e falte kurrë. Të gjendur përballë vendosmërisë sonë, ligjit për ruajtjen e repartit, falë mbështetjes së gjithanshme të pjesës më të madhe të popullatës të fshatit Zall-Herr, turmat e irrituara u zmbrapsën disa herë, duke bërë të pamundur rënien e këtij reparti elitë të quajtur, ‘Komando’.

Mbrojtja e repartit na kushtoi shumë, ne humbëm heroin

Çdo gjë për atdhe, “Komando” jemi ne!



tonë të përkushtuar shefin e Xhenios, ushtarakun e nderuar Kapitenin I Nuredin Gorçe, Dëshmorin e Atdheut, i cili ra në krye të detyrës për të mbrojtur infrastrukturën ushtarake të repartit, duke e bërë këtë repart të pamposhtur, përballë çdo rreziku sado i vështirë që ishte. Ne krenohemi me këtë repart, jo vetëm se pikërisht në këto ngjarje djemtë e kësaj njësie e kanë treguar veten, por më pas ishte ky repart të cilit iu dha detyra të kryente sigurinë e objekteve të rëndësishme shtetërore, jo vetëm në Tiranë, por anembanë vendit.

Emri ‘Komando’ është lartësuar dhe vazhdon të lartësohet me misionet e tyre jashtë vendit, duke filluar nga Bosnje–Hercegovina, Afganistani, Iraku, Chadi dhe së fundi në Kosovë, ku ‘Komandot’ me disiplinën dhe profesionalizmin e tyre kanë shkëlqyer, duke mbajtur lart emrin e madh që kanë. Do doja të sillja në vëmendje të gjithë heronjtë e këtyre ngjarjeve, duke filluar nga Komandanti i Brigadës, kolonel Arben Çuko, kolonel Fatmir Lokaj, n/ kolonel Rexhep Bleta, major Vladimir Vladi, major Shaqir Koliçaj, major Hajri Zhukri, major Përparim Tota, major Lulzim Sefa, major Asqeri Çeta, major Aleko Çuli, major Vangjel Ndini, kapiten Liman Hoxha, kapiten Behar Mara, kap Fatmir Lleshi, kapiten Haki Dingu, kapiten Elidon Shehu, kapiten Altin Bundo, kapiten Ylli Prifti, kapiten Musa Hida, toger Julian Prenga, kapiten Flamur Melani, kapiten Petrit Baçe, kapiten Besnik Saliasi, n/officerët: Arjan Rasa, Lutfi Hoxha, Ramazan Xhepa, Astrit Hoxha e të tjerë, të cilët kanë meritat e tyre të veçanta që historia në memorien e saj do t’i përmendë, si heronjtë e heshtur, të cilët i bënë një shërbim të madh vendit të tyre.

Përkujtohet Dëshmori i Atdheut Nuredin Gorçe

Në ambientet e Regjimentit të Operacioneve Speciale (ROS), u zhvillua ceremonia përkujtimore e 28-vjetorit të rënies në krye të detyrës së Dëshmorit të Atdheut kapiten I Nuredin Gorçe.

Në këtë aktivitet, ishin të pranishëm efektivë të ROS, familjarë dhe miq të Dëshmorit të Atdheut kapiten I Gorçe.

Jeta dhe vepra e kapiten I Gorçes, në shërbim të atdheut, duke mos kursyer as jetën e tij, përbën burim frymëzimi jo vetëm për efektivët e ROS, por për të gjithë ushtarakët e Forcave të Armatosura. Ceremonia përkujtimore vijoi me vendosjen e kurorave dhe buqetave me lule, pranë bustit dhe memorialit kushtuar Dëshmorit të Atdheut kapiten Nuredin Gorçe. Ish-shefi i xhenios së Brigadës “Komando”, u nda nga jeta në vitin e mbrapshtë 1997. Lavdi Dëshmorëve të Atdheut! Përlësisht veprës së tyre!





FJALA PËRSHËNDETËSE E SHEFIT TË SHTABIT TË PËRGJITHSHËM, GJENERALLEJTËNANT ARBEN KËNGJI ME RASTIN E 26 - VJETORIT TË KRIJIMIT TË KOMPANISË EOD

Të nderuar oficerë, nënoficerë dhe punonjës civilë të Kompanisë EOD të Forcave të Armatosura, kam nderin dhe kënaqësinë që t'ju përcjell urimet më të përzemërta me rastin 26 - vjetorit të krijimit të Kompanisë EOD.

Në këtë përvjetor, dua të shpreh vlerësimin për përkushtimin dhe ekspertizën e jashtëzakonshme të shfaqur nga personeli i Kompanisë EOD, i cili ka përmbyshur misionet më të rëndësishme, për të siguruar një të ardhme më të sigurt për vendin tonë dhe për rajonin. Në këtë ditë të shënuar, përkulemi me nderim përpara kujtimit të Dëshmorëve të Atdheut, major Klodian Tanushi, nëntetare Zarife Hasanaj, kapter Agim Mekollari, rreshter Namik Gjolena dhe tetar Sadik Basha, të cilët ranë në krye të detyrës.

Kompania EOD është një gur - themeli për sigurinë kombëtare dhe rajonale, duke hequr çdo kërcënim që mund të cenonte jetën dhe pasurinë e njerëzve.

Njëherazi, dua të theksoj kontributin e jashtëzakonshëm të Kompanisë EOD, duke mundësuar sigurinë e garantimin e zhvillimit ekonomik e turistik në gjithë hapësirën gjeografike të vendit, nëpërmjet pastrimit e kthimit në normalitet të zonave të rrezikshme për jetën dhe sigurinë e popullsisë.

Shërbimi ndaj atdheut është dhe do të jetë detyrimi ynë i përhershëm. Shpreh bindjen e palëkundur se do ta përmbyshni me sukses misionin tuaj kushtetues, duke punuar të gjithë së bashku me përkushtim, ndershmëri dhe profesionalizëm!

Gëzuar 26 - Vjetorit të Krijimit të Kompanisë EOD!

EOD, histori krenarie, guximi dhe trimërie

Më 19 mars 1999, në Forcat e Armatosura mori jetë një grup i ri ekspertësh dhe profesionistësh xhenier, i kompletuar me ekspertizën e duhur në lëmin e asgjësimit të municioneve të paplasura. Në këtë nënrepart u thirrën më të mirët e të mirëve, pasi ky profesion kërkon guxim, dhe qartësi, për të marrë vendimin e duhur, ku jetën nga vdekja e ndan vetëm një vijë e hollë e padukshme.

Për 26 vjet kjo strukturë na ka bërë krenar si brenda dhe jashtë vendit duke ngritur për herë të parë flamurin tonë në Bosnjë, në Mali, Letoni etj.

Prej ditës së parë të krijimit të grupit të asgjësimit të municioneve të tepërta e të rrezikshme, kompania EOD (Explosive Ordnance Disposal) vjen me një bilanc pune të jashtëzakonshëm.

Mbi 1 mijë ha sipërfaqe të pastruara nga municionet e paplasura, mbi dhe nëntokësore.

Mbi 55 mijë tonë municione të asgjësuar, të llojeve të ndryshme dhe kalibrave të ndryshëm. 15 grup-depo të certifikuar dhe pjesëmarrje në misionet ndërkombëtare, si "Althea" në Bosnje dhe Hercegovinë, EUTM Mali, dhe grup – batalioni i NATO-s në Letoni.

Falë punës së specialistëve EOD vendi ynë tani është më i pastër nga minat dhe eksplozivët e paplasur.

Por për të arritur deri këtu u desh dhe gjaku i 5 martirëve që dhanë jetën në krye të detyrës, e sot emri i tyre është gdhendur në historinë e ndritur të këtij reparti për t'u kujtuar përjetë. Kjo komandë është e jashtëzakonshme nga rëndësia që ka në mbështetjen e operacioneve dhe jashtë vendit, tashmë ka fituar edhe një emër në hapësirën e NATO-s.

Njësisia EOD, e cila shërben në Letoni prej vitesh me rrotacion çdo 6-muaj është një kapacitet i madh tashmë i njohur edhe nga shtetet e tjera dhe që me të vërtetë, ndonëse jemi një vend i ri dhe i vogël në këtë aleancë, në këtë kapacitet specifik kemi bërë emër shumë të mirë edhe kemi marrë falënderime.

Specialistët EOD (Explosive Ordnance Disposal) kanë luajtur një rol kyç në pastrimin e minave dhe eksplozivëve të paplasur në vendin tonë. Konkretisht, ata kanë kryer këto veprime:

- Zbulimi i minave dhe eksplozivëve – Përdorimi i pajisjeve të specializuara, si detektorët e metaleve dhe dronët me sensorë të avancuar, për të identifikuar objektet e rrezikshme.

- Asgjësimi i sigurt – Ekspertët EOD kanë çaktivizuar ose shkatërruar minat dhe municionet e paplasura për të shmangur aksidentet.

- Pastrim dhe sigurim i zonave – Pas heqjes së rrezikut, zonat janë shpallur të sigurta për banorët dhe përdorim të mëtejshëm, si bujqësia apo ndërtimi.

- Trajtime dhe ndërgjegjësim – Kanë edukuar komunitetet lokale për rreziqet e minave dhe si të veprojnë nëse hasin eksplozivë të dyshimtë.

- Bashkëpunim me institucionet – Kanë punuar me autoritetet shtetërore dhe organizatat ndërkombëtare për të siguruar financim dhe mbështetje teknike për pastrimin e territoreve.

Këto veprime kanë bërë që shumë zona të bëhen të sigurta



për jetën dhe zhvillimin ekonomik të vendit.

Detyra e tyre është pastrimi i vendit nga municionet, për të siguruar jetën e njerëzve në çdo cep të Shqipërisë.

Modernizimi i pajisjeve dhe investimi i vazhdueshëm në kapacitete njerëzore e kanë transformuar këtë Togë në një nga më të rëndësishmet e Forcave të Armatosura.

Specialistët EOD kanë vepruar në disa prej territoreve më të rrezikshme në vendin tonë, ku minat dhe eksplozivët

e paplasur kanë qenë një kërcënim serioz për komunitetet lokale. Disa nga këto zona përfshijnë:

Kufiri me Kosovën – Gjatë dhe pas luftës në Kosovë, shumë zona kufitare me Shqipërinë u ndotën me mina dhe eksplozivë të mbetur nga konfliktet. Rajone si Tropoja, Kukësi dhe Hasi, janë pastruar nga ekipet EOD;

Veriu dhe verilindja e Shqipërisë – Zona malore të prekura nga lëvizjet ushtarake të viteve të kaluara, ku janë zbuluar municione të paplasura dhe mina të mbetura nga epoka komuniste;

Ish-zonat ushtarake, ish-repartet ushtarake dhe depot e municioneve në Shqipëri, sidomos në Gërdec, ku shpërthimi i madh i vitit 2008 la pas shumë eksplozivë të rrezikshëm;

Zona e Dumresë – Një zonë me shumë ish-depo municionesh, ku janë gjetur eksplozivë të paplasur të mbetur nga periudha e kaluar;

Bregdeti jugor – Disa zona afër bazave të vjetra ushtarake kanë pasur mbetje eksplozive, duke përfshirë gadishullin e Karaburunit dhe Sazanin.

Pastrimi i këtyre territoreve ka shpëtuar jetë dhe ka hapur rrugën për zhvillimin ekonomik dhe turistik të tyre.

Krenar për djemtë dhe vajzat tona, të përkushtuar në punën dhe misionin e pastrimit të vendit nga municionet e rrezikshme!

Që prej krijimit, 25 vjet më parë, kompania e Asgjësimit të Municioneve të Pashpërthyer EOD ka luajtur një rol të pazëvendësueshëm jo vetëm në sigurinë e reparteve ushtarake dhe territoreve përreth, por edhe në sigurinë e banorëve dhe veprave civile.

Prej 8 vitesh efektivët e EOD kontribuojnë në grup-batalionin e NATO-s në Letoni, duke bërë një punë të jashtëzakonshme për të mbrojtur dhe siguruar interesat e Aleancës së NATO-s. Përulemi me respekt ndaj sakrificës sublime të dëshmorëve: major Klodian Tanushi, kapter Agim Mekollari, rreshter Namik Gjolena, tetar Sadik Basha dhe nëntetar Zarife Hasanaj.





ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Ushtaraku që sfidën e ka kthyer në moton e jetës

Me kalimin e viteve, çdo sfidë është kthyer në një histori force dhe krenarie, ndaj në 80-vjetorin e krijimit të një prej institucioneve elitë të arsimit në Shqipëri, Shkollës ‘Skënderbej’, ku ti nise rrugëtimin tënd me uniformën e gjelbër në moshën 14-vjeçare, një djalë i ri me ëndrra të mëdha, me pasion dhe përkushtim për këtë thirrje që u bë pjesë e shpirtit tënd.

Sot, pas 40 vitesh shërbimi, ti je ende po ai njeri, i fortë, i vendosur, me zemrën të mbushur me dashuri për këtë detyrë që nuk ka qenë kurrë thjesht një punë për ty, por një mision i shenjtë. Koha ka bërë të sajën, ai djali i ri me shkëlqim në sy është sot një burrë me përvojë dhe me një histori të gjatë sakrifice pas shpatullave. Ke kaluar mes stuhish, sfidash, ke përballuar mungesën në shtëpi për të qenë aty ku atdheu të ka thirrur.

Djali ynë të shikon me admirim, e sheh forcën tënde dhe ndjen krenari për ty. Ai e di se çfarë do të thotë të kesh një baba që i ka dhënë vendit gjithçka, por që kurrë nuk e ka harruar familjen e tij. Ai rritet duke ndjekur shembullin tënd, duke mësuar se nderi, besnikëria dhe përkushtimi janë vlera që nuk blihen, por fitohen me punë dhe sakrificë.

Çdo sakrificë e jotja nuk ka qenë e kotë, çdo mëngjes që je zgjuar para diellit dhe çdo natë që ke qëndruar zgjuar për detyrën tënde ka lënë një gjurmë të pashlyeshme.

Ushtaraku që sfidën e ka kthyer në moton e jetës

Nuk ka jetë të lehtë për një ushtarak. Çdo ditë është një betejë, jo vetëm në shërbim të atdheut, por edhe me veten, me lodhjen, me mungesën, me vendimet e vështira që duhet të marrë. Dhe ti, nuk ke kërkuar rrugë të lehta. Që ditën kur veshe për herë të parë atë uniformë, e ke ditur se kjo nuk do të ishte thjesht një zgjedhje profesionale, por rrugëtim i jetës.

Sfidat nuk të kanë thyer, përkundrazi, të kanë bërë më të fortë. Ato kanë qenë provat që të kanë formuar si njeri, si luftëtar, si një figurë e palëkundur mes stuhive.

Në momentet kur të tjerët dyshonin, ti ke qëndruar i pathyeshëm. Në ditët kur rruga dukej e errët, ti ke gjetur dritën brenda vetes.

Ti nuk e ke parë sfidën si pengesë, por si mundësi. Nuk je tërhequr kurrë përballë vështirësive, sepse e di që vetëm ai që guxon dhe përballet, arrin të ecë përpara. Dhe kjo është arsyeja pse sot je njeriu që je, një njeri me vlera, me përvojë, me një histori që frymëzon.

Motoja jote ka qenë dhe mbetet: “Asnjë sfidë nuk është më e madhe se vendosmëria ime”. Dhe kjo është arsyeja pse të gjithë ata që të njohin, të shohin me respekt dhe krenari.

Sepse ti nuk je thjesht një ushtarak

Ti je shembulli i një njeriu që sfidën e ktheu në forcë dhe uniformën në një nder të përgjithshëm. 40 vite në rrugëtimin e vështirë të ushtarakut, kurrë nuk u zmbrapse, 40 vite nuk janë thjesht një numër, por një jetë e tërë e shkrirë në disiplinë, sakrificë dhe përkushtim. Janë vite të kaluara mes stuhive dhe diellit, mes sfidave dhe triumfeve, mes betejave të jashtme dhe atyre të brendshme. Që në hapin e parë, e dije se rruga e një ushtaraku nuk do të ishte e lehtë. Net pa gjumë, urdhra të fortë, detyra që kërkonin gjithçka nga ti. E megjithatë, asnjëherë nuk u zmbrapse. Nuk lejon që lodhja të të thyejë, as frika të të ndalë. Ti ke qëndruar i pathyeshëm, i vendosur, gjithmonë i gatshëm të përballësh me çdo sfidë.

Në këto 40 vite ke parë shumë, sakrifica që vetëm një ushtarak mund t'i kuptojë. Uniforma jote nuk është thjesht një veshje, është një pjesë e shpirtit tënd, një emblemë që e ke mbajtur me krenari. Sot, pas gjithë këtyre



viteve, mund të shikosh pas dhe të thuash me bindje: “Nuk u dorëzova. Nuk u zmbrapsa. Unë qëndrova dhe i qëndrova besnik betimit tim!”.

Krenaria nuk matet me gradat që ke mbajtur, por me respektin që ke fituar

Dhe ti, pas 40 vitesh, nuk je thjesht një ushtarak me përvojë, je një simbol i forcës, një dëshmi e palëkundur e një jete të jetuar me nder dhe dinjitet.

Sepse një ushtarak i vërtetë nuk tërhiqet kurrë. Ai ecën përpara, gjithmonë. Dhe ti je prova më e mirë e kësaj.

Një ushtarak i vërtetë para së gjithash është njeri...

Nuk është vetëm uniforma që vesh, por zemra jote e madhe, përkushtimi yt, sakrifica jote, janë ato që të bëjnë një njeri të jashtëzakonshëm.

Ne jemi mirë, sepse e dimë që po bën atë që ke ëndërruar gjithmonë. Por, mbi të gjitha, e di që çdo hap që hedh është për ne, për të ardhmen tonë, për sigurinë dhe lumturinë tonë. Një ushtarak është i fortë dhe i qëndrueshëm, por jo i pandjeshëm. Dashuria e tij shprehet në mënyra të heshtura, në mbajtjen e premtimeve, në përgjegjësinë për sigurinë e familjes dhe në kthimin gjithmonë në shtëpi, sado larg të jetë dërguar. Nuk është gjithmonë i pranishëm fizikisht, por zemra e tij është gjithmonë aty. Ai di të dojë me veprime, jo vetëm me fjalë. Një njeri me uniformë është i strukturuar, i disiplinuar dhe i mësuar të respektojë hierarkinë dhe urdhrat. Ky mentalitet reflektohet edhe në familje, ai beson në vlerën e rregullit, përgjegjësisë dhe organizimit.

Nuk është i ashpër, por kërkon që gjërat të kenë një strukturë, ashtu si në jetën e tij profesionale.

Një ushtarak e sheh fjalën e dhënë si të shenjtë. E njëjta gjë vlen edhe për premtimet e tij në familje.

Në çdo vendim që merr, ai shpesh duhet të zgjedhë midis familjes dhe detyrës. Dhe megjithëse detyra e thërret larg, familja është arsyeja pse ai lufton.

Ai është mburojë për vendin dhe një mbrojtës për familjen. Kjo e bën të fortë, por ndonjëherë edhe të heshtur për ndjenjat e veta.

Rrugëtimi i një ushtaraku nuk është kurrë vetëm. Pas çdo uniformë qëndron një familje, një nënë e cila lutet, një baba krenar, një bashkëshorte mbështetëse dhe fëmijë që presin me padurim kthimin e një heroi.

Ashtu si ushtarakët mbrojnë atdheun me guxim dhe përkushtim, familjet e tyre janë shtylla e forcës së tyre.

Është mbështetja, dashuria dhe mirëkuptimi i familjes që i jep një ushtaraku forcën për të qëndruar i palëkundur përballë sfidave dhe sakrificave.

Të jetosh me një ushtarak do të thotë të mësosh të jesh e fortë. Do të thotë të mbështetesh në dashurinë dhe besnikërinë e tij, edhe në mungesë. Por mbi të gjitha, do të thotë të ndjesh krenari, për atë që ai është, për shërbimin e tij dhe për vlerat që sjell në familje.

Në fund, një bashkëshorte do të thoshte: “Ai është burri im, është njeriu im i fortë, dhe pavarësisht sakrificave, ai është gjithmonë heroi ynë”.



HALIL RAMA, MJESHTËR I MADH

Pas një karriere të shkëlqyer në Forcat e Armatosura të RSH, Hamdi Doda, me dekretin e Presidentit Nr.87, datë 28.02.2025 ka marrë gradën madhore ‘Gjeneral Brigade’. Ai është ndër të vetmit ushtarakë me origjinë nga Muhurri, që ka përfaqësuar Shqipërinë në NATO dhe që ka takuar Sekretarin Amerikan të Shtetit, John Kerry dhe Sekretarin Amerikan të Mbrojtjes Donald Rumsfeld, si përfaqësues i FA-së, pjesëmarrës në Misionin “Liria e Irakut”. Karriera e tij në strukturat e Forcave tona të armatosura njeh ngjitje, nga Komandant i Kompanisë së Ndërlidhjes në Brigadën e Këmbësorisë, Muhurr, shef ndërlidhje në Batalionin e Tankeve në Dovolani dhe Batalionin e Parë të Brigadës së Këmbësorisë Bulqizë, Komandant i Kompanisë së Radios në Batalionin e Ndërlidhjes të Divizionit të 8-të të Këmbësorisë në Tiranë, Drejtor i Drejtorisë së Ndërlidhjes në Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, Komandant i Agjencisë së Sistemeve të Ndërlidhjes dhe Informacionit, Rrapi i Treshit (ish-Brigada e Ndërlidhjes), dhe deri detyrë Komandant i Agjencisë së Sistemeve të Ndërlidhjes dhe Informacionit në Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, detyrë të cilën e ushtron edhe sot.

Ai ka lindur, më 5 maj 1970, në fshatin Vajmëdhej të Rrethit të Dibrës. Ka kryer shkollën fillore në fshatin e lindjes dhe atë 8-vjeçare (1980-1984) e të mesme të përgjithshme në Shkollën “Nexhat Agolli” në Muhurr (1984-1988). Nga viti 1988-1992, ka studiuar dhe është diplomuar në Akademinë Ushtarake të Forcave të Armatosura, në Specialitetin Ndërlidhje, në Tiranë. Nga fëmijëria mban mend dhe kujton me respekt të veçantë mësuesit e tij, nga klasa e parë deri në klasën e tetë si dhe shokët e shoqet e klasës, sakrificat e tyre, përkushtimin, vështirësitë, gjithashtu dhe aktivitetet sportive (spartakiada) që bëheshin në ato kohë. Kujton me nostalgji momentet kur zhvilloheshin ndeshjet e futbollit midis shkollave të mesme ku mbronte, si shqiptonjë portën e ekipit të shkollës. Edhe pse i vogël në moshë u zgjodh dhe u aktivizua si “gardian i portës” për ekipin e kooperativës së Muhurrit. Kështu ai ruan respekt të veçantë për mësuesit e klasës së parë, Bilal Rina dhe Sinan Tanushi (nga klasa e parë deri në klasën e katërt). Të njëjtin respekt ruan edhe për mësuesit e shkollës 8-vjeçare, në veçanti për mësuesen kujdestare Hike Iskurti (Hoxha) dhe për mësuesit e shkollës së mesme, si Sadik Selishta, Fadil Bushi, Shahin Lazri, Lavdrim Shehu dhe Fehmi Mikli, por edhe për Drejtorët e shkollës së mesme Gafurr Zoto dhe Baftjar Gazidede/Shehu.

Në shkollë u njoh dhe me Nadiren, një nxënëse e shkëlqyer, e cila më pas erdhi në Universitet dhe sot është nëna e dy fëmijëve të tyre, Enriku dhe Lusjela. Enriku ka përfunduar studimet e larta, bachelor për shkencë ekonomike “Economic Sciences” në Universitetin “Libre du Bruxelles” në Bruksel, në gjuhën frënge, kurse vajza, Lusjela, ka përfunduar studimet e larta në Universitetin “Epoka”, dega Informatikë Ekonomike “Business Informatics” në Tiranë, si dhe ka përfunduar me rezultate të larta studimet master në fushën e sigurisë kibernetike “Digital Forensic and Information Security” në Mbretërinë e Bashkuar pranë Universitetit “East London University”.

Gjeneral brigade Hamdi Doda është i biri i Dine Dodës, një burrë i nderuar, me ndikim në komunitet dhe i vlerësuar publikisht në zonën e Muhurrit dhe më gjerë në gjithë Dibrën.

Hamdi Doda, në vitin 1992 merr titullin “Oficer Aktiv” me gradën “Nëntoger” dhe emërohet Komandant i Kompanisë së Ndërlidhjes në Brigadën e Këmbësorisë, Muhurr. Nga viti 1993 deri në vitin 1995 ka punuar shef ndërlidhje në Batalionin e Tankeve në Dovolani dhe Batalionin e Parë të Brigadës së Këmbësorisë Bulqizë, Dibër. Nga Nëntori i vitit 1995 deri në Qershor të vitit 1997 ka studiuar në Turqi, ku është diplomuar për Gjuhën Turke, në Institutin Ushtarak të Gjuhës Turke në Stamboll, si edhe kursin bazë të Oficerit për Ndërlidhje, në Shkollën Ushtarake për Ndërlidhjen dhe Elektronikën në Ankara, Turqi. Në përfundim të studimeve në Turqi, për rreth një vit, ka ushtruar detyrën e komandantit të Kompanisë së Radios në Batalionin e Ndërlidhjes të Divizionit të 8-të të Këmbësorisë në Tiranë. Gjatë kësaj periudhe kujton me nostalgji profesionale Certifikimin e grupit të Fundit të Radio-telegrafistëve në rang Force të Armatosur. Nga marsi i vitit 1998 deri në tetor të vitit 2008 ka ushtruar detyra të ndryshme në Regjimentin Komanda Zall-Herr, fillimisht si komandant toge dhe Specialist për Planëzimin dhe Menaxhimin e Sistemeve të Ndërlidhjes dhe Informacionit deri në Shef Ndërlidhje Regjimenti.

Ditëlindja e 29-të, gjatë luftës së Kosovës

Në mars të vitit 1999, së bashku me trupat komando dislokohehet në Perollaj për të mbrojtur dhe siguruar me përkushtim kufirin midis Kosovës dhe Shqipërisë, vija kufitare nga Morina - Kukës, Qafë Prush dhe deri në Qafë Morinë - Tropojë. E paharruar për të është ditëlindjen e 29-të (në Maj të vitit 1999) që i takoi ta festonte në një nga pozicionet e Artilerisë Tokësore, të ndërtuar

HAMDI DODA, GJENERALI QË KA PËRFAQËSUAR SHQIPËRINË NË NATO



nga regjimi komunist. Nuk i harron ato momente lufte kur së bashku me kolegët festonin në një ambient të përshtatur për “Bar - kafe”, si edhe dhuratën e bërë nga shokët: një kapele dhe një peshk (dekorativ).

Në periudhën tetor 2004 - prill 2005, Hamdi Doda përzgjidhet dhe merr pjesë në kontingjentin e katërt të Misionit “Liria e Irakut” (“Iraqi Freedom Mission”). Së bashku me 70 veta personel të Regjimentit Komando kryejnë me sukses misionin fisnik dhe kthehen në Atdhe. Ajo që është për t’u nënvizuar është mirënjohja e madhe dhe vlerësimet shumë pozitive të dhëna nga forcat aleate, paqeruajtësit shqiptarë, lidhur me aftësitë dhe profesionalizmin e demonstruar gjatë zbatimit të detyrave, si dhe takimi me Sekretarin Amerikan të Shtetit, John Kerry, i cili në janar 2005, vizitoi Bazën e Mosulit, ku krahas forcave Amerikane ishin të dislokuar edhe Forcat Shqiptare. Në mënyrë speciale bëri një takim me drejtuesit e trupave Amerikane, ku morën pjesë edhe oficerët e kontingjentit shqiptar (kjo e kërkuar nga ana e tij). Në takim vlerësoi me nota maksimale kontributin e vendit tonë si dhe shkallën e lartë të profesionalizmit të treguar nga gjithë kontingjenti. Ish-presidenti i SHBA-ve, Xhorxh W. Bush, në dhjetor 2008, ka shprehur mirënjohje dhe vlerësim për kontributin e dhënë nga FA të Republikës së Shqipërisë, në kuadër të misionit gati pesëvjeçar në operacionin e koalicionit, “Liria e Irakut”, duke theksuar: “Tashmë që forcat ushtarake shqiptare përfundojnë shërbimin e tyre të gjatë në Irak, kam dëshirë të shpreh mirënjohjen e thellë të Shteteve të Bashkuara për qeverinë dhe popullin e Shqipërisë, për trupat që kanë kontribuar për forcën ndërkombëtare në Irak nga prilli i 2003 deri në dhjetor të 2008. Populli i Shqipërisë duhet të jetë krenar për pjesëmarrjen e suksesshme për të ndihmuar Irakun që të sigurojë lirinë e vet. Ne presim me gëzim të shërbejmë së bashku me kontingjentet e ardhshme shqiptare në mbrojtje të lirisë. Eksperienca jonë e përbashkët në Irak, tregon shembullin më të mirë sesi partneriteti midis vendeve tona është thelluar në vitet e fundit”, duke shprehur optimizmin se lidhjet e Shqipërisë do të forcohen ndërkohë që Shqipëria zë vendin e saj si anëtare e NATO-s, duke rritur bashkëpunimin me qeverinë amerikane.

Takimi me Sekretarin Amerikan të Mbrojtjes

Në muajin shtator të vitit 2006 Hamdi Doda përzgjidhet si përfaqësues i FA-ve të Shqipërisë, pjesëmarrëse në misionin, për t’u takuar me Sekretarin Amerikan të Mbrojtjes Donald Rumsfeld. Ky ishte një takim i veçantë dhe i paharruar edhe për vajzën Lusjela, vetëm 6 vjeçe, e cila përzgjidhet për t’i dhuruar tufën me lule të freskëta Zotit Rumsfeld. Për këtë takim mediat e asaj kohe shkruan me germa të mëdha “Dibranja e vogël që thyen Protokollin”, i shtrëngon dorën Sekretarit Amerikan të Mbrojtjes. Gjatë periudhës që shërbeu në Njësinë Elitare të Forcave të Armatosura “Trupat Komando”, Hamdiu drejtoi grupin e punës për hartimin e projektit për modernizimin e rrjeteve kompjuterike në këtë njësi, projekt i cili u finalizua me sukses. Në mars të vitit 2007 nisjet me studime në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, fillimisht në Institutin e Gjuhës Angleze në Bazën Ajrore “Lack Land Air Force Base, në Teksas (mars-korrik 2007). Bazuar në rezultatet e shkëlqyera vlerësohet me “Certificate of Achievements”. Po në të njëjtën periudhë, arrin të mbrojë me certifikatë edhe gjuhën angleze. Në gusht të vitit 2007 deri në janar të vitit 2008 ndjek studimet në Korpusin e Trupave Amerikane të Ndërlidhjes, Baza Ford Gordon, Augusta, Georgia SHBA. Në përfundim të studimeve renditet si

studenti më i mirë ndërkombëtar, ku vlerësohet me Certifikatë Nderi. Pas kthimit nga studimet në Amerikë, për një periudhë të shkurtër emërohet specialist për Sistemet Statike në Komandën e Forcës së Bashkuar, në Plepa Durrës. Në tetor të vitit 2008 emërohet Shef i Degës së Ndërlidhjes në Komandën e Forcave Detare, Plepa, Durrës, detyrë të cilën e kryen me sukses deri në korrik 2012, ku krahas detyrës funksionale drejton edhe grupin e punës për hartimin e studimit për mirëmbajtjen e Sistemit të Vëzhgimit të Hapësirës Detare. Në dhjetor të vitit 2009 fiton të drejtën për herë të dytë, për të ndjekur Kursin për Menaxhimin e Burimeve të Mbrojtjes, në një nga Institutet më të njohura në Amerikë, Instituti i Menaxhimit të Burimeve të Mbrojtjes, “Defence Resource Management Institute”, Monterey, Kaliforni.

Në korrik të vitit 2012, Hamdi Doda përzgjidhet për të punuar për një periudhë tre vjeçare si Oficer Shtabi për Ndërlidhjen në Përfaqësinë Ushtarake të Republikës së Shqipërisë në NATO. Gjatë kësaj periudhe përfaqëson denjësisht Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë në Bordin e Konsultim-Komandim-Kontrollit të NATO-s. Pas përfundimit me sukses të detyrës në NATO, nga korriku i vitit 2015 deri në shtator të vitit 2018 emërohet Oficer Shtabi për Planëzimin, Standardizimin dhe Implementimin e Objektivave të Kapaciteteve në Drejtorinë e Ndërlidhjes në Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura. Gjatë kësaj periudhe, krahas detyrës funksionale si ekspert i fushës, merr pjesë në grupe pune për hartimin e kërkesave operacionale për modernizimin e sistemeve të ndërlidhjes dhe informacionit në nivel Force të Armatosur, gjithashtu përfaqëson Drejtorinë e Ndërlidhjes në takimet Bilaterale me NATO-n, lidhur me implementimin e Objektivave të Kapaciteteve.

Në vitin 2018 Hamdi Doda ka marrë pjesë në misionin e NATO-s, KFOR, në Kosovë. Në përfundim të misionit është dekoruar me medalje nga Komandanti i KFOR-it, gjeneralmajor Salvatore Cuoci për kontribut të shquar në mision. Në shtator të vitit 2018 emërohet Drejtor i Drejtorisë së Ndërlidhjes në Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura (niveli më i lartë i detyrës/përfaqësimit për një oficer Ndërlidhje). Gjatë kësaj periudhe, krahas pjesëmarrjes në grupe pune dhe borde për standardizimin dhe modernizimin në nivel Force të Armatosur, përzgjidhet si anëtar i grupit të punës në nivel kombëtar, ngritur me Urdhër të Kryeministrit për hartimin e Strategjisë Kombëtare për Sigurinë Kibernetike. Në prill të vitit 2019 emërohet Komandant i Agjencisë së Sistemeve të Ndërlidhjes dhe Informacionit të Rrapi i Treshit (ish Brigada e Ndërlidhjes) detyrë të cilën e ushtron edhe sot.

Në shtator 2019 Hamdi Doda është promovuar me gradën “Kolonel”. Ai, krahas studimeve dhe kualifikimeve brenda vendit ka kryer studime afatgjatë dhe afatshkurtër jashtë vendit, ku mund të përmendim, kursin Bazë të Oficerit të Ndërlidhjes në Ankara, Turqi, Kursin e Kapitenit të Karrierës dhe Kursin e Menaxhimit të Burimeve të Mbrojtjes në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, si dhe Program Studimin për Sigurinë Kibernetike “George C Marshall” në Oberamergau Gjermani. Gjeneral brigade Doda në vitin 2011 përfundoi Kursin e Komandës dhe Shtabit të Përgjithshëm pranë Akademisë së Mbrojtjes së FA-së, ku fitoi Gradën Shkencore “Master Shkencor në fushën e Sigurisë dhe Mbrojtjes”.

Në vitin 2017 përfundoi Kursin e Lartë të Oficerit pranë Akademisë së Forcave të Armatosura, dhe në vitin 2023 përfundoi Kursin e Lartë të Sigurisë dhe Mbrojtjes, pranë Kolegjit të Mbrojtjes dhe Sigurisë.

Ai ka marrë pjesë dhe kontribuar, në konferenca, seminare, workshope dhe grupe pune, veçanërisht në fushën e Ndërlidhjes dhe Sigurisë Kibernetike, si brenda dhe jashtë vendit. Përgjatë karrierës 33-vjeçare në FARSH, për shërbimet e kryera, gjeneral brigade Doda është nderuar me një numër medaljesh karriere, shërbimesh të veçanta në MM dhe SHP. Gradat i ka fituar një e nga një, ashtu si e detyron rregullorja e gradave në ushtri.

Ka përfaqësuar vendin tonë në konferenca, takime dhe seminare ndërkombëtare në fushën e Ndërlidhjes dhe Sigurisë Kibernetike. Në vitet 2010-2011 ka mbrojtur provimet pasuniversitare në Inxhinieri Elektronike si dhe ka mbrojtur gjuhën angleze pranë Fakultetit të Gjuhëve të Huaja në Tiranë. Ka shërbyer si përkthyes në gjuhën turke për grupin e eksperteve turq të atashuar në Regjimentin Komando në Zall-Herr, Tiranë. Për pjesëmarrjen në misionin ndërkombëtar është dekoruar me medalje e tituj nderi si me, “Medaljen e Shërbimit Ushtarak”. Gjeneral Doda ka trajtuar kryesisht tema për Ndërlidhjen, Sigurinë Kibernetike dhe Masat për Sigurinë e Sistemeve të Komunikimit e Informacionit në FA.

Me kualifikimet në SHBA, Turqi, Gjermani e Austri dhe eksperiencat e vyera e karrierën e tij të shkëlqyer, gjeneral Hamdi Doda radhitet me ushtarakët më të zotë të Forcave tona të armatosura.

Kolonel Hamdi Doda, aktualisht me detyrë Komandant i Agjencisë së Sistemeve të Ndërlidhjes dhe Informacionit në Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes merr gradën madhore ‘Gjeneral Brigade’, me dekretin e Presidentit të Republikës SH.T. z Bajram Begaj nr. 87, datë.28.02.2025.



KAPITEN (P) VERI TALUSHLLARI

Skënderbegasit në Nju Jork hapin festimet e 80-vjetorit të shkollës “Skënderbej”

Një e diel e bukur marsi këtu në Nju Jork. Ora 12.00 “63 Bar”, një klub shqiptarësh në Rixhvd, Kuins, ka marrë pamje festive. Së bashku me zonjën Dirka Xhakolli, në rolin e Sekretarit të Përgjithshëm dhe zëvendës presidentes së Shoqatës SKËNDERBEJ, bëjmë mikpritësin. Vijnë nga çdo cep i metropolit të famshëm ish - skënderbegas të brezave të ndryshëm. Kreun si më i moshuari e mban Haxhi Sejdarasi, skënderbegas i vitit 1961, e më i riu, i diplomuar në fund-vitet ’80 është Xheladin Hoxha.

“Nuk më mbante vendi, - thotë Besnik Pazaj, që ka ardhur nga Nju Xhersi, i mbështetur në një karrige me rrota, për shkak të një aksidenti. - I thashë djalit, hajde të shkojmë, dua të takoj shokët, vëllezërit. Kam qenë skënderbegas unë, kam kaluar vështirësi ku e ku më të mëdha! E kur? Kur isha 15 vjeç djalë!”.

Salla mbushet me tingujt e muzikës dhe zërit të këngës së njohur të Skënderbegasit, kënduar nga Kujtim Turku. Takohen shokë e miq, disa edhe pas vitesh e dekadash, e, ndërsa Flutura Zekaj, Blerta Gjevori dhe Përparim Seitaj kujdesen për shtrimin e tavolinave, bisedat kanë hyrë në rrjedhën e kujtimeve.

Presidenti i Nderit i Shoqatës, prof. kolonel (P) Gëzim Mustafaj është kujdesur që në monitorin e madh në mur të shfaqen dokumentarë dhe foto e video nga jeta jonë në atë shkollë. Ai flet për historikun e Shkollës ‘SKËNDERBEJ’, nga ajo ditë e largët e 28 Marsit 1945, kur bankat e saj u mbushën me rreth 200 partizane e partizanë të vegjël, detyra e të cilëve, tani që Shqipëria ishte çliruar nga nazifashistët, do të ishte lufta për dije. Në fjalën e tij, z. Gëzim përshkruan rrugëtimin e Shkollës, rritjen dhe formimin e atyre rreth 33 mijë nxënësve që i dhanë shkëlqim jo vetëm emrit të Shkollës, por edhe mbajtën mbi supë me dinjitet çdo detyrë e përgjegjësi, në radhët e Ushtrisë, por edhe në çdo fushë të jetës ku i thirri Atdheu. Ai nuk harron të vlerësojë komanduesit dhe mësuesit tanë, për gjithçka të mirë na mësuan dhe edukuan. Ky përshkrim i bën edhe më të prekshme vitet tona të rinisë e të asaj Shkolle që me arsye quhet Legjendë.

Në monitor shfaqet Gazeta ‘KALORËSIT E SKËNDERBEUT’. Është nr.3 i gazetës online të Shoqatës sonë. Titullin “ia morëm” Fan Nolit, ai e quante veten pikërisht kështu, ‘Kalorës

GËZUAR 80-VJETORIN SHKOLLA JONË E DASHUR “SKËNDERBEJ”!



i Skënderbeut’, por ne menduam se dhe neve na shkonte për mrekulli ai emër. Bëj një koment të shkurtër të shkrimeve, dhe u bëj thirrje pjesëmarrësve të kontribuojnë edhe ata, sepse nuk mund ta mbajnë gazetën vetëm Gëzim Mustafaj, Petrit Xhaferri, Engjëll Zerdelia, Fejzo Lalaj me skicat e tij apo Alessia e vogël që shkruan plot ndjenjë për gjyshin, Qazim Gjevorin.

Festa rrjedh gëzueshëm me shëndete dhe kujtime e tregime nga ato vite. Gazmend Kuçuku, një pilot i ri dhe i shkathët në vitet 90-të kur punonim bashkë në Bazën Ajrore të Kuçovës, është burrrëruar, madje dhe flokët e bukur nuk i ka më. Ai ka ardhur bashkë me një tjetër pilot, Albert Xhafaj, që vetëm disa muaj më parë fluturonte me helikopter në Bazën Ajrore të Farkës, por tashmë ka ardhur të jetojë pranë fëmijëve këtu në NY. Albertit i bën përshtypje lidhja dhe organizimi i ushtarakëve këtu, dhe këtë e shpreh me kënaqësi në fjalën e tij.

Festën tonë nuk mund të mos e lidhim me përgatitjet që MM, Akademia e FA dhe shoqatat e ushtarakëve në Shqipëri po bëjnë për 28 Marsin, dhe Presidenti i ri i Shoqatës, i zgjedhur një muaj më parë, z. Gëzim Shentolli, pasi përshëndet të pranishmit, njofton se i kemi propozuar MM të nderojë dy anëtarë të moshuar të Shoqatës sonë dhe me kontribute të shquara në Ushtrinë Shqiptare, K/Admiral (P) Muharrem Kuçana dhe Kol (P) Bektash Shamenti. Gjithashtu jepen Certifikata Mirënjohjeje për disa anëtarë të Shoqatës sonë.

Dirka Xhakolli, oficerë në pension tashmë, grua, nënë dhe vjehrrë oficerësh amerikanë, madje dhe me baba e vjehërr oficerë, tregon ç’do të thotë të jetosh mes kaq burrave e grave, të gjithë ushtarakë. Astriti, bashkëshorti, i përgjigjet me humor dhe pjesëmarrësit duartrokasën e i përgëzojnë për atdhetarinë, përkushtimin, sakrificat...

Disa nga pjesëmarrësit kanë hedhur në rrjet pamje nga festa dhe miq e dashamirës nga Shqipëria e vende të tjera dërgojnë mesazhe urimi.

Mynyr Saliq, një ish-skënderbegas mallakastriot dëshiron të thotë dy fjalë nga Xheksonvillë, Florida. “Do të kisha ardhur, - thotë, - por jam pak pa qejf. Ju uroj dhe ju përqafoj!”.

